



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT**

**Data 12.10.2023**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“ Blerje Dru Zjarri të Sharuara dhe Pelet ”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Kodi PCV Dru zjarri 03413000-8 & Lëndë druri 03419000-0**

**VLERA E FONDIT LIMIT :**

Fondi Limit për 1(një) vit kalendarik: **4.559.666** ( katër milion e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtë qind e gjashtëdhjetë e gjashtë ) **Lekë pa TVSH** , dhe fond limit total për **4 (katër) vjet : 18.238.663** (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e tetë mijë gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre )**Lekë pa T.V.SH .**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Qendra Ekonomike e Arsimit pranë Bashkisë Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

- Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, do të jetë **çmimi më i ulët** .

- Afati kohor për dorëzimin e ofertave është data **30.10.2023** ora **08 : 00** .
- Afati kohor për hapjen e ofertave është data **30.10.2023** ora **08 : 00** .

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

**Argumentimi** : Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

***Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.***

**2.2.2** Vërtetimi të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit ushtrimorë duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të ketë një vlerë jo më të ulët se 80% e vlerës së fondit limit që prokurohet .

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale , në të paktën një vit të perjudhës së kërkuar nga autoriteti /enti kontraktor .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pikat 2 , gërma b si dhe neni 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve dhe xhiros mesatare është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji

**2.2.3** Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen për taksat vendore për vitin 2023, lidhur me afatet e kryerjes të pagesave të caktuara nga njësit e vetëqeverisjes vendore, pran njësite vendore ku operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet sipas QKB, në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” .

**Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB, si dhe gjithë vërtetimet e mësipërme .**

***Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve dhe xhiros mesatare është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të

ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh ; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**".*

- Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen për taksat vendore për vitin **2023** , në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" kudo që operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet sipas QKB .

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR , si dhe gjithë vërtetimet e mësipërme.

***Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore , (i Ndryshuar).

### **Për Taksat Lokale**

Në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiscal”.

*Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale për vitin 2023 është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore " dhe në proporcion të drejtë me objektin e prokurimit, nga ku operatorët ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë vërtetimin për pagesën e vitit 2023 ( i cili paguhet jo më vonë se data 20 janar të vitit pasardhës).*

**2.2.4** Vërtetim i shlyerjes së gjithë detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për të gjithë kontratat të energjisë që disponon operatori ekonomik.

***Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 7, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

## **2.3 Aftësitë teknike**

**2.3.1.** Furnizime të ngjashme jo më të vogël se 30 % të fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit ushtrimorë duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit.

*Në rast të përvojës të mëparshme të realizuar me ente publike* duhet të paraqitet kontrata shoqëruar me vërtetimin për realizimin e sukseshëm të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*Në rast të përvojës të mëparshme të realizuar me sektorin privat* duhet të paraqiten fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara nga organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara .

**Argumentimi** : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Ku me anë të këtij kriteri në pikën “4” thuhet se - *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim që Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë :**

### **2.4.1 Çertifikatat ISO si mëposht:**

- a) Çertifikatë ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalent .
- b) Çertifikatë ISO 14001:2015 për sistemin e menaxhimit të mjedisit ose ekuivalent.

**Argumentim:** Në bazë të dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO ( Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit ) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve

Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë . Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standarteve të cilësise me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qendrueshëm me avantazhe reciproke.

## ARGUMENTIM

- Çertifikatë **ISO 9001 : 2015** për sistemin e menaxhimit të cilësisë është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit, e cila është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit . Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor kërkon siguri nga operatorët ekonomik ofertues që të operatorë sipas standarteve ISO për mallrat që do të sjelli .
- Çertifikatë **ISO 14001- 2015** mbi “ Sistemet e menaxhimit të mjedisit”

Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor .

Kjo çertifikat është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit “ **Blerje dru zjarri të sharuara dhe Pellet** ” në rastin konkret, njësia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të çertifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të



- 2.4.2** Deklarat nga ana e operatorit ekonomik që merrë përsipër transportin , shpërndarjen dhe stivosien e produkteve (druve) objekt prokurimi në të gjitha institucionet e Bashkisë Kuçovë dhe njërive administrative , në çdo kohë dhe sipas kërkesës së AK-së .

## ARGUMENTIM

Për të provuar këtë duhet të paraqesë kontratë lidhur me Sektorin Përgjegjës për Pyjet pranë Bashkisë përkatëse për shfrytëzimin e lëndës drusore ( lejen e shfrytëzimit sipas legjislacionit në fuqi ), Kontrate furnizimi, ose të paraqesë fatura blerje dru zjarri për të gjithë sasinë e kërkuar .

Bazuar në nenin 36 dhe 771 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” gjithashtu bazuar edhe në nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku shprehimisht parashikohet se :

Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor ka parashikuar nevojën për furnizim me mallra objekt prokurimi blerje dru zjarri, ndarë sipas nevojës së parashikuar dhe pasqyruar në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës”, së procedurës së prokurimit. Sa më sipër, synimi final i autoritetit kontraktor është furnizimi me mallrat objekt prokurimi dhe me anë të kriterëve të veçanta të kualifikimit, ky i fundit duhet të sigurohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës përmbushin këto të fundit me synim realizimin e kontratës objekt prokurimi. Në kriteret e veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit, ndër të tjera autoriteti kontraktor ka parashikuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë Leje shfrytëzimi pyjesh të lëshuar nga autoritet përkatëse, Kontrate furnizimi, ose të paraqesë fatura blerje dru zjarri për të gjithë sasinë e kërkuar.

Synimi i autoritetit kontraktor ( mbi furnizimin me mallrat objekt prokurimi) realizohet edhe në forma të tjera, të ndryshme nga shfrytëzimi i pyjeve, si në rastin me kontratat e furnizimit ose fatura tatimore të mallrave ( dru zjarri ) objekt i procedurës së prokurimit, duke e lënë të hapur mënyrën e përmbushjes së këtij kriteri në respekt të nenit 2 të ligjit Nr 162 datë 23.12.2020 Për prokurimit publik, duke nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës .

Duke parë afatin e marrëveshjes kuadër, vlerës e saj dhe rëndësin autoriteti kontraktor kërkon garanci nga operatorët ekonomik për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë , të cilët duhet të ketë një pikë të ushtrimit të aktivitetit të tyre brenda territorit të Bashkisë Kuçovë, në pronësi ose me qera, kjo për arsye të furnizimit të përditshëm dhe delikat për të gjitha institucionet arsimore dhe para arsimore .



**2.4.3** Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën **2(dy)** motosharra profesionale në funksion të zbatimit të kontratës për produktin dru zjarri . Për këtë të paraqitet fatura blerje, kontrata hua përdorje noteriale ose fatura zhdoganimi .

### **ARGUMENTIM**

Bazuar në nenin 77,pika 1 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” , ku shprehimisht parashikohet se :

**1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar*



kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

- Gjithashtu në nenin 40 , pika 5 , gërma ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Dy motosharra profesionale janë të nevojshëm për zbatimin e kontratës, sepse në momentin e dorëzimit të druve të zjarrit pranë çdo institucioni, operatori ekonomik do bëjë prerjen e druve sipas nevojave të tyre. Në këtë mënyrë ato janë të domosdoshme dhe në kuptim të nenit 46 të ligjit të prokurimit publik, i krijon bindjen autoritetit kontraktor që operatori ekonomik fitues do të përmbushë me sukses zbatimin e kontratës .



**2.4.4** Për produktin Pelet Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes pranë Autoritetit Kontraktor katalogët / fragmentet e katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për autoritetin e prodhuesit për produktin objekt prokurimi. Fragmentet e katalogut duhet të tregohen lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog dhe prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë , duhet të përmbaj karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të plotësuara në dokumentat e tenderit .



**2.4.5** Për produktin Pelet operatori ekonomik ofertues , duhet të paraqes kontrat furnizimi nga prodhuesi /distributori i autorizuar i cili të jetë i pajisur me licencë me kodin III.2.B për prodhim Peleti , për këtë procedur objekt prokurimi ose autorizim prodhuesi / distributori zyrtar për mallrat objekt të këtij prokurimi .Në rastë paraqitje deklarata furnizimi /autorizim distributori , operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes një akt-marrveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre . Kontrat furnizimi /autorizim duhet të përmbaj të dhëna të plota të prodhuesit si (tel,fax, email, webside) .

#### ARGUMENTIM

Në bazë të nenit **Neni 40 për Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave** , pika 5, gërma “a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime,për sa mësipër Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë licencë për prodhimin e pelletit dhe kjo është e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rastë verifikimi nga ana e tij si dhe leje mjedisore për prodhim peleti .

## ARGUMENTIM



**2.4.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraes mostrat(kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në DST , nga jo më pak se një kampion në paketim origjinal për produktin objekt prokurimi.Mostra e kërkuar duhet të ketë një etiket të ngjitur e cila do të përmbaj : moster (emëri i artikullit) , nr. rendor sipas ofertës të paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit , nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues) . Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara për Peletin.

Në bazë të nenit **Neni 40 për Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave** , pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime , ku thuhet se në pikën 6 neni 40 se Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose



**2.4.7** Operatori duhet të disponojë ambjent për ruajtjen dhe magazinimin e produkteve me sipërfaqje minimale 100 m<sup>2</sup> . Ambjenti të jetë i pajisur me çertifikatë të sigurisë ndaj zjarrit lëshuar nga organet kompetente si dhe të jetë me afat të vlefshëm në datën e hapjes së tenderit.

## ARGUMENTIM

Në bazë të nenit **Neni 40 për Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime , ku pikën 8 dhe 9 të këtij neni shprehimisht thuhet si më poshtë:

- 8.** *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

**9. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.**

Duke parë objektin e kontratës që prokurohet, vlerën dhe afatin e saj është e rëndësishme që operatorët ekonomik pjesëmarrës të zotërojnë një ambient me sipërfaqje minimale prej 100 m<sup>2</sup>, e cila siguron autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës, duke treguar kapacitetet organizative të tyre, gjithçka në fuksion të zbatimit të kontratës. Magazina do të shërbejë që operatorët ekonomik ofertues do të magazinonjë drutë e zjarrit, duke garantuar AK që furnizimi do të jetë pa ndërprerje duke mos sjellë vonesa në lëvrimin e tyre .

Ndërsa në lidhje me çertifikatën e sigurisë ndaj zjarrit, për shkak të vetë objektin të kontratës që do prokurohet “ Blerje dru zjarri të sharuara dhe Pellet ”, kjo çertifikate është e lidhur ngushtë e cila është e nevojshme që magazina të sigurohet nga rrezik i ndonjë zjarri të mundshëm .



- 2.4.8** Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 2( dy) mjete transportuese ATP në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës, leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit dhe çertifikatë transporti, lejet e drejtimit të shoferave si dhe librezat shëndetësore të drejtuesve të mjeteve .  
Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, si dhe të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri dhe lloji i mjeteve, pajisjeve në pronësi ose me qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar furnizimeve të mallrave sipas grafikut dhe kohëzgjatjes së kontratës. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.



- 2.4.9** Në funksion të zbatimit sa më korrekt të kontratës operatori ekonomik duhet të paraqes një vërtetim për numrin mesatar të punonjësve të paktën minimum i 4 (katër ) punonjës

të siguruar për periudhën Qershor 2023 –Gusht 2023 (nga të cilët 2 shoferë të konfirmuar me kodin përkatës në listëpagesa, dhe 2 (dy ) të jenë punonjës të thjeshtë të nevojshëm për shkarkimin e druve ) . Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë :

- Listëpagesat sipas formularit elektronik ( E-Sig 025) ;

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

- Numri prej minimalisht 4(katër) – persona, ku nga këta 2 (dy ) duhet të jenë shoferë të pajisur me lejet e drejtimit, kontrate pune si dhe librezat shendetesore, si dhe 2 (dy) punonjës të thjeshtë të pasqyruar në listëpagesa me kodin përkatës me kodin përkatës ,numri i punonjësve është përlllogaritur referuar furnizimit të mallrave objekt prokurimi që do të kryejë operatori ekonomik fitues me qëllim realizimin e këtij shërbimi për një periudhën 48 mujore duke filluar nga data e lidhjes së kontratës.

Nisur dhe nga grafiku i lëvrimit të mallrave të hartuar nga Qendra Ekonomike e Arsimit si në vitet paraardhës, njësia e prokurimit gjykon se ka vendosur një numër minimal punonjësish dhe se, qëllimi i autoritetit kontraktor është zbatimi i kontratës me sukses dhe në kohë duke mos sjellë vonesa në lëvrimin e mallrave objekt prokurimit.

Gjykuar nga sa më sipër, njësia e prokurimit vlerëson se ka kërkuar një numër minimal punonjësish që duhet të disponojnë operatorët ekonomik ofertues në përmbushje të zbatimit të kontratës në kohë.

Numri i punonjësve tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik është e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Duke arsyetur që objekti i prokurimit është për furnizimin me dru zjarri dhe pelet për kopshte , çerdhe, shkolla dhe zyra, njësia e prokurimit gjykon se numri i kërkuar i punonjësve të sipërcituar ( shoferë dhe punonjës të thjeshtë) është në përpjestim të plotë me objektin e kontratës dhe i shërbim njëkohësisht qëllimit të autoritetit kontraktor, duke garantuar këtë të fundit për zbatimin me sukses dhe në kohë.

- Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të plotësojë kriteret e mësipërme ( për kapacitetin ekonomik, financiar dhe teknik ) , sipas nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, në raport me përqindjen e punës që ka marrë përsipër të kryeje, sipas akt-marrëveshjes së lidhur midis operatorëve ekonomik .

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

- **Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**
- **Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**
- **Dhënia e informacionit të rremë, përbën shkak për skualifikim, si dhe do të veprohet konform parashikimeve të LPP.**

## SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MALLRAVE OBJEKT PROKURIMIT

### Specifikimi i druve të zjarrit :

- 1) **Drutë duhet të jenë të prera dhe të çara në pore vertikale .**
- 2) **Të jenë të thata .**
- 3) **Drutë e zjarrit do të jenë prej ahu dhe dushku .**
- 4) **Drutë do të shpërndahen në institucionet përkatëse me automjetet e operatorit ekonomik .**
- 5) **Njësia matëse e druve të zjarrit do të jetë në m<sup>3</sup>**

- 6) **Drut duhet të jenë të prera në një gjatësi jo më tepër se 30cm dhe diametër jo më tepër se 8cm**

**Karakteristikat teknike minimale të lëndës djegëse pellet**

Lloji I drurit Ah ose lis (vetëm tallash I pastër , jo lëvozhga druri )

Vlerat kalorike 4.6 kwh/kg (16.5mj/kg)

Qëndrushmëria mekanike 98w-% +-1

Përmbajtja e lagështisë 5- 10%

Përmbajtja e plurit : <0.75

Densiteti 750kg/m<sup>3</sup> D 600KG/m<sup>3</sup>

Paketimi 10-20kg

Diametri 6 mm +- 1

**PREVENTIV**

**Objekti: “Blerje Dru zjarri te sharuara dhe Pellet “ per Qendren Ekonomike te Arsimit, Sasia e Druve të zjarrit të sharuara dhe Pellet këtu është përlogaritur për një vit .**

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1.	Pellet	kg	7000
2.	Dru zjarri	m <sup>2</sup>	497.33
	<b>Shuma pa TVSH për (1) një vit kalendarik</b>		
	<b>T V SH (20 % )</b>		
	<b>Totali</b>		